

# **Ndalimi i ndëshkimit trupor në shkolla**

**Përgjigje në pyetjet që  
shtrohen më së shpeshti**



Në këtë seri:

**Ndalimi i ndëshkimit trupor të fëmijëve:**

Përgjigje në pyetjet më të shpeshta

**Ndalimi i ndëshkimit trupor të fëmijëve:**

Pyetje dhe përgjigje për fëmijë dhe të rinjë

PUBLIKUAR MË 2017 NGA:

**Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve**

[www.endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org)

"Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve" administrohet nga shoqata për Mbrojtjen e të gjithë Fëmijëve, "APPROACH" Ltd, një shoqatë bamirëse e regjistruar me nr. 328132.

Zyra e regjistrimit: "Foundry, 17 Oval Way", Londër SE11 5RR, MB.

**Save the Children Suedi**

[www.raddabarnen.se](http://www.raddabarnen.se); [resourcecentre.savethechildren.net](http://resourcecentre.savethechildren.net)

Save the Children Suedi është pjesë e Save the Children Association (Shoqata Save the Children), një fondacion ky që përbëhet prej 29 organizatave të ndryshme të Save the Children, të regjistruara në Zvicër dhe një prej organizatave më të mëdha për të drejtat e fëmijëve në botë. Save the Children Association është edhe pronar i Save the Children International (SCI), që është organizatë ndërkombëtare për implementimin e programit.

Zyra kryesore e Save the Children Suedi: Rädga Barnen, SE-107 88 Stokholm, Landsvägen 39, Sundbyberg, Suedi.

Ky material/botim është financuar nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësinë për përmbajtjen e këtij materiali e mban plotësisht hartuesi. Qeveria e Suedisë nuk ndan medoemos pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura në këtë botim.

**A**tëherë kur bëhen lëvizje për të ndaluar ndëshkimin trupor në shkolla, janë disa pyetje që zakonisht shtrohen. Ky doracak ofron përgjigjet në disa prej këtyre pyetjeve dhe ka për qëllim të qartësojë çështjet kryesore që janë pjesë e tyre. Ky doracak duhet të ju jep besim zyrtarëve qeveritarë, profesionistëve të arsimit dhe të tjerëve që punojnë drejt ndalimit që të vazhdojnë me reformën ligjore dhe të lëvizin një hap më afër realizimit të së drejtës së fëmijëve për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës në të gjitha rrethanat.



# Pyetjet

## **Pjesa 1: Parimet bazë**

- 8** Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje ligjore nga ndëshkimi trupor
- 11** Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje ligjore nga dhuna në të gjitha rrethanat
- 12** Problemet e disiplinës nuk duhet të ngatërrohen me zgjidhjet e disiplinës

## **Pjesa 2: Ndalimi i ndëshkimit trupor të fëmijëve në shkolla: Përgjigjet në pyetjet e shtruara më së shpeshti**

- 16** Shumë mësime kundërshtojnë ndalimin e ndëshkimit trupor. A duhet t'i dëgjojmë ata, meqë janë ata që merren me disiplinën në shkollë për çdo ditë?
- 18** Pse e rezistojnë mësuesit ndalimin e ndëshkimit trupor?
- 22** Nëse dëshironi t'u mësoni fëmijëve respektin dhe disiplinën, atëherë natyrisht që duhet të përdorni ndëshkimin trupor?

- 26** E kuptoj që goditja e një fëmije deri në lëndim ose vdekje është e papranueshme, mirëpo nëse ndiqen si duhet rregulloret për administrimin e ndëshkimit trupor, ky i fundit paraqet një element të rëndësishëm dhe efektiv të politikës disiplinore të një shkolle?
- 30** Disa shkolla fetare thonë që besimi i tyre kërkon nga ato që të përdorin ndëshkim trupor. A është diskriminim ndalimi i tyre që ta bëjnë këtë?
- 32** Shumë mësimdhënës dhe personelë të tjerë janë në stres nga menaxhimi i klasave të tej-ngarkuara dhe kjo për shkak të mungesës së burimeve. A nuk do ta shtonte edhe më shumë stresin e tyre ndalimi i ndëshkimit trupor?
- 34** Ne tashmë kemi politikë ministrore/në shkollë kundër ndëshkimit trupor. Pse është e nevojshme që të ndryshohet edhe ligji?

### **36 Pjesa 3: Uebfaqe dhe burime të nevojshme**

# **Pjesa 1:**

# **Parimet bazë**



# Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje ligjore nga ndëshkimi trupor

Pothuajse çdo shtet në botë ka ratifikuar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe prandaj edhe e ka për detyrë që t'i zbatojë të drejtat që i përmban ajo. Neni 28 (2) i Konventës thekson se metodat e disiplinës në shkolla duhet të jenë “në përputhje me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në pajtim me Konventën aktuale”. Komisioni për të Drejtat e Fëmijës, i cili monitoron zbatimin e Konventës, e ka interpretuar në mënyrë të vazhdueshme këtë nen duke kërkuar ndalimin e ndëshkimit trupor në shkolla. Organet e monitorimit të traktateve të tjera kanë theksuar gjithashtu se ligji ndërkombëtar dhe ai rajonal i të drejtave të njeriut kërkon ndalimin e ndëshkimit trupor në shkolla.

Prandaj, ndalimi i ndëshkimit trupor në shkolla kuptohet më së miri si një obligim i të drejtave të njeriut. Hulumtimet kanë një vend të rëndësishëm në zbulimin e mbizotërimit të ndëshkimit trupor, monitorimin e zbatimit të ndalimit dhe zhvillimin e qasjeve pjesëmarrëse pozitive, jo të dhunshme, efektive në disiplinën e shkollës. Por nuk është i nevojshëm hulumtimi për të “dëshmuar” se ndëshkimi trupor në shkolla duhet të ndalohej: kjo çështje është një prej çështjeve të të drejtave të njeriut.



Megjithatë, ekziston një evidencë e madhe hulumtuese që dëshmon se ndëshkimi trupor ka një efekt të dëmshëm në mësim-nxënie. Në një studim të kohëve të fundit, përvoja e ndëshkimit trupor në shkollë ishte e lidhur me rezultate më të dobëta në teste dhe me efekte negative në mirëqenien psiko-sociale të fëmijëve.<sup>1</sup> Dhuna në shkollë - duke përfshirë edhe ndëshkimin trupor - është gjithashtu një arsye kryesore përse fëmijëve nuk u pëlqen shkolla dhe kontribuon në braktisjen e shkollës.<sup>2</sup>

Sipas Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e miratuar nga udhëheqësit botërorë në Shtator të vitit 2015, shtetet janë zotuar që të mobilizojnë përpjekjet e tyre për krijimin e "mjedisve të mësim-nxënës të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive për të gjithë" (synimi 4a) dhe për t'i dhënë fund të gjitha formave të dhunës kundër fëmijëve (synimi 16.2). Përfundimi i ndëshkimit trupor të fëmijëve në shkolla - dhe në të gjitha mjediset - është thelbësor në arritjen e këtyre synimeve dhe të synimeve të tjera shëndetësore dhe arsimore.

1. Zyra për hulumtime e UNICEF – "Innocenti" (2015), "Corporal Punishment in Schools: Longitudinal Evidence from Ethiopia, India Peru and Viet Nam", Florencë: Zyra për hulumtime e UNICEF

2. Iniciativa globale (2016), "Corporal punishment of children: review of research on its impact and associations", në dispozicion në <http://endcorporalpunishment.org/research/impact-corporal-punishment.html>

**“Fëmijët  
kanë të drejtë  
për të ju  
respektuar  
dinjiteti i  
tyre njerëzor  
dhe integriteti  
trupor.”**

# Fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje ligjore nga dhuna në të gjitha rrethanat

Obligimi i shteteve për të ndaluar ndëshkimin trupor të fëmijëve bazohet në të drejtën e fëmijëve për respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor dhe integritetit trupor, si qenie njerëzore. Përderisa ky doracak trajton temën shumë të rëndësishme të ndalimit të ndëshkimit trupor në shkolla dhe pyetjet specifike që ngritë kjo temë, qeveritë dhe profesionistët e arsimit duhet të jenë të vetëdijshëm se fëmijët kanë të drejtë për të ju respektuar dinjiteti i tyre njerëzor dhe integriteti trupor në të gjitha mjediset e jetës së tyre, përfshirë këtu shtëpinë, mjediset e kujdesit për fëmijët, kujdesin alternativ, institucionet penale dhe ushtrinë.


# Problemet e disiplinës nuk duhet të ngatërrohen me zgjidhjet e disiplinës

Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis problemeve të disiplinës në shkolla si dhe mënyrave në të cilat shkollat u përgjigjen atyre. Ekziston një tendencë në mesin e atyre që janë kundër ndalimit që të tregojnë sjelljen e fëmijëve si demonstrim i nevojës për ndëshkim trupor. Por, sjellja e fëmijëve nuk kërkon një përgjigje të dhunshme.

Problemet e disiplinës në shkollë rezultojnë nga një kombinim i shumë faktorëve, duke përfshirë ata që lidhen me rrethanat individuale të fëmijës, mjedisin shkollor, mënyrën se si mësohet profesioni i mësimit dhe mbështetja në një vend të caktuar, përshtatshmëria e kurrikulës, e të tjera. Disiplina e dobët në shkollë paraqet një dështim në identifikimin dhe trajtimin e duhur të shkaqeve të problemit të perceptuar; kjo nuk vjen si pasojë e mosfunksionimit të ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve.

Trajtimi i problemeve disiplinore kërkon ndërhyrje kreative, të ndjeshme, të mbështetura, respektuese dhe profesionale, dhe jo goditjen dhe poshtërimin e nxënësve. Ekzistojnë shumë burime, që janë në dispozicion, për krijimin dhe mbajtjen e menaxhimit të mirë të klasës duke respektuar të drejtat e fëmijëve (shih Pjesën 3 për shembuj të zgjedhur).





**Pjesa 2:  
Ndalimi i  
ndëshkimit  
trupor të  
fëmijëve në  
shkolla:**

**Përgjigjet  
në pyetjet e  
shkruara më  
së shpeshti**



# Shumë mësimdhënës kundërshtojnë ndalimin e ndëshkimit trupor. A duhet t'i dëgjojmë ata, meqë janë ata që merren me disiplinën në shkollë për çdo ditë?


Qeveritë duhet të angazhohen me mësimdhënësit për sfidat me të cilat ballafaqohen ata, megjithatë në këtë çështje - si të tjerat, duke përfshirë edhe dhunën kundër grave, diskriminimin racor dhe shëndetin publik - qeveritë kanë përgjegjësi që të udhëheqin, dhe të mos ndjekin opinionin publik. Theksi duhet të vihet në obligimin e qeverisë për të drejtat e njeriut, për të siguruar që ligji u siguron fëmijëve, ashtu si të rriturve, mbrojtjen e plotë të dinjitetit të tyre njerëzor, dhe pastaj të punojnë bashkë me mësimdhënësit dhe t'i mbështesin ata për të siguruar zbatimin e ligjit.

Dëshmitë nga hulumtimi gjithashtu tregojnë qartë se disiplina jo e dhunshme dhe pozitive sjell rezultate më të mira në klasë, ndërsa ndëshkimi trupor shoqërohet me shumë rezultate negative, duke përfshirë rezultatet më të ulëta në IQ (koeficient të inteligjencës), fjalorë më të kufizuar, aftësi njohëse më të dobëta, zhvillim njohës më të ngadalshëm dhe nota të dobëta në shkollë.<sup>3</sup>

3. Ogando Portela, M. J. & Pells, K. (2015), "Corporal Punishment in Schools Longitudinal Evidence from Ethiopia, India, Peru and Viet Nam – Innocenti Discussion Paper 2015-02", Florencë: Zyra për hulumtimit e UNICEF



Shpesh kjo jepet si arsye për mos-vijimin ose braktisjen e shkollës.<sup>4</sup> Përsëri, është përgjegjësi e qeverisë që të udhëheqë në mbikëqyrjen e adaptimit të qasjes mësimdhënëse më efektive në të gjithë sistemin arsimor, duke mbështetur mësimdhënësit në zhvillimin e strategjive disiplinore jo të dhunshme dhe pozitive nëpërmjet trajnimit, mbështetjes, burimeve të mjaftueshme dhe qeverisjes së mirë në shkolla, si dhe duke dërguar një mesazh të qartë se ndalimi i ndëshkimit trupor në shkolla nuk është më i ligjshëm.



4. Pinheiro, P. S. (2006), "World Report on Violence against Children", Gjenevë: Kombet e Bashkuara

# Pse e rezistojnë mësimdhënësit ndalimin e ndëshkimit trupor?

Përveç arsyeve të përshkruara më sipër, ekzistojnë disa arsye se pse mësimdhënësit mund ta kundërshtojnë ndalimin:

## **Shprehia, tradita, familjariteti me të**

Ndëshkimi trupor është përdorur zakonisht në shkolla në të kaluarën, është pranuar gjerësisht nga shoqëria në profesionin e arsimit, dhe është përkrahur dhe madje nganjëherë edhe inkurajuar nga prindërit. Mësimdhënësit ndoshta do ta kenë përjetuar vetë atë gjatë shkollimit të tyre. Dhe shumë mësimdhënës janë edhe prindër që mund të kenë përdorur ndëshkimin trupor në rritjen e fëmijëve të tyre.

Por, kohët ndryshojnë dhe shoqëritë ecin përpara. Njohja e fëmijëve si mbajtës të të drejtave kërkon veprim për t'i dhënë fund ligjshmërisë dhe pranimin social të dhunës ndaj fëmijëve, meqë shoqëritë kanë lëvizur drejt përfundimit të pranimin të dhunës ndaj grave. Kjo nuk është çështje e fajit - në të kaluarën mësimdhënësit kanë vepruar në përputhje me pritjet sociale - por ka ardhur koha për të lëvizur në raporte pozitive dhe jo të dhunshme me fëmijët.

## **Ligjshmëria**

Përderisa ligji autorizon ndëshkimin trupor në shkolla, kjo është parë si një mënyrë legjitime e trajtimit të disiplinës në shkolla. Politikat, këshillat dhe udhëzimet që promovojnë teknikat disiplinore pozitive do të kenë ndikim të kufizuar atëherë kur ato dëmtohen nga ligjet që lejojnë ndëshkimin trupor. Edhe kur ligji i arsimit duket të jetë i heshtur lidhur me këtë çështje, pranimi pothuajse universal i një shkalle të ndëshkimit trupor në rritjen dhe edukimin e fëmijëve mund të nënkuptojë që edukatorët ndihen të justifikuar në përdorimin e forcës dhe u shkaktojnë dhimbje dhe/ose poshtërojnë një nxënës nën maskën e disiplinës.

Ndalimi i qartë ligjor i ndëshkimit trupor dërgon një mesazh të qartë që dhuna ndaj fëmijëve në shkolla nuk është më e pranueshme dhe i hap rrugë adaptimit të teknikave më respektuese, më pozitive dhe më efektive.

### **Besimi**

Në shkollat fetare, përdorimi i ndëshkimit trupor mund të mbështetet dhe të inkurajohet nga interpretime të veçanta të teksteve fetare. Mund të ketë mungesë të vetëdijesimit të interpretimeve alternative, të cilat do të promovonin masat disiplinore jo të dhunshme dhe të rritjes së mbështetjes së bazuar në besim për t'i dhënë fund përdorimit të ndëshkimit trupor. Shih 'Disa shkolla fetare thonë që besimi i tyre kërkon që ato të përdorin ndëshkimin trupor. A është diskriminim ndalimi i atyre për ta bërë këtë?' (faqe 30) për më shumë detaje.

### **Mungesa e njohurisë**

Besimi se ndëshkimi trupor është i domosdoshëm dhe efektiv në menaxhimin e disiplinës shkollore mund të rezultojë nga mungesa e njohurisë për metodat e disiplinës pozitive, për të drejtat e fëmijëve, për zhvillimin e shëndoshë të fëmijës dhe për mënyrën se si mësojnë fëmijët, për joefektshmërinë e ndëshkimit trupor si masë disiplinore dhe për efektet negative tek fëmijët dhe aftësinë e tyre për të mësuar, si dhe për dallimet ndërmjet ndëshkimit dhe disiplinës. Mësimdhënësit gjithashtu mund të mos vlerësojnë shumë presionet me të cilat ballafaqohen fëmijët, të cilat mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të mësuar dhe në sjelljen e tyre. Të gjitha këto tema duhet të mbulohen gjatë trajnimit fillestar dhe trajnimeve gjatë punës së mësimdhënësve.

## Stresi i mësimdhënësve

Mësimdhënësit mund të mos jenë të trajnuar mirë, të nënpaguar dhe të nënvlerësuar, klasat mund të jenë të mëdha dhe shkollat mund të kenë burime të dobëta. Kjo mund të pakësojë durimin e mësimdhënësve dhe të rezultojë në zemërim dhe reagime jo të duhura ndaj sjelljes së fëmijëve, "goditje" dhe vështirësi në arritjen e menaxhimit të mirë të klasës. Sidoqoftë, kjo nuk mund të jetë një justifikim për mësimdhënësit që të shfryejnë stresin e tyre tek nxënësit. Shih 'Shumë mësimdhënës dhe personelë të tjerë janë në stres nga menaxhimi i klasave të tej-ngarkuara dhe kjo për shkak të mungesës së burimeve. A nuk do ta shtonte edhe më shumë stresin e tyre ndalimi i ndëshkimit trupor?' (faqe 32) për një diskutim më të plotë të stresit të mësimdhënësve.

.....

Të kuptuarit e këtyre arsyeve mund të ndihmojë në komunikimin me mësimdhënës lidhur me nevojën për ndalim dhe vendosjen e masave të duhura për të siguruar zbatimin e tij. Sidoqoftë, asnjë prej tyre nuk duhet të përdoret si justifikim për mbajtjen e ndëshkimit trupor, madje as si "mjet i fundit", dhe asgjë nuk e ndryshon obligimin e menjëhershëm të të drejtave të njeriut për të ndaluar ndëshkimin trupor.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se pothuajse të gjitha shtetet që e kanë ndaluar ndëshkimin trupor në shtëpi e kanë bërë këtë përpara opinionit publik dhe pastaj opinionit publik ka mbështetur ndryshimin. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me ndalimin në shkolla. Ndonëse mund të ketë një numër të vogël njerëzish të cilët vazhdojnë të fajësojnë ndalimin e ndëshkimit trupor në shkolla për të gjitha problemet e disiplinës - një argument pothuaj gjithmonë i bazuar në keqinformim dhe shtrembërim të fakteve - për shumicën, sapo që ndëshkimi trupor të mos jetë më një zgjidhje, kur mësimdhënësit janë të trajnuar në një varg të qasjeve pozitive në menaxhimin e klasës, ditët kur rrahen fëmijët për mos bërjen e detyrave të shtëpisë do të duken të egra dhe barbare.



# Nëse dëshironi t'u mësoni fëmijëve respektin dhe disiplinën, atëherë natyrisht që duhet të përdorni ndëshkimin trupor?

Ky argument vjen prej idesë se goditja e fëmijëve është në "interesin e tyre më të mirë". Kjo po ashtu ngatërron disiplinën me ndëshkimin dhe respektin me frikën.

(i) **"Interesi më i mirë"** i një fëmije. Komisioni për të Drejtat e Fëmijës adreson këtë çështje në mënyrë të përmbledhur në Komentin e tij të përgjithshëm nr. 8 për "Të drejtën e fëmijës për mbrojtje nga ndëshkimi trupor dhe format e tjera mizore ose degraduese të ndëshkimit (nenet 19; 28, paragrafi 2; dhe 37, midis tjerash)" (paragrafi 26):<sup>5</sup>

"... interpretimi i interesave më të mira të fëmijës duhet të jetë në përputhje me gjithë Konventën, përfshirë këtu obligimin për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës dhe kërkesën për t'i dhënë peshën e duhur pikëpamjeve të fëmijës; Nuk mund të përdoret për të justifikuar praktikën, duke përfshirë ndëshkimin trupor dhe format e tjera të dënimit mizor ose degradues, të cilat bien ndesh me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe të drejtën për integritet trupor."

(ii) **Disiplina kundrejt ndëshkimit.** Menaxhimi i mirë i klasës nuk është i njëjtë me ndëshkimin. Nuk bazohet në forcë, por rritet nga mirëkuptimi, respektimi i ndërsjellë dhe komunikimi efektiv. Ndëshkimi trupor është pak më shumë se një mësim për sjelljen e keqe, duke u mësuar fëmijëve që të rriturit e konsiderojnë të pranueshme përdorimin e dhunës për të zgjidhur problemet ose konfliktet. Në Komentin e Përgjithshëm Nr. 8, Komisioni për të Drejtat e Fëmijës shpjegon se derisa ndëshkimi trupor përjashtohet, disiplina njihet si thellësisht e rëndësishme për një fëmijëri të shëndoshë (paragrafi 13):

5. Në dispozicion në Anglisht, Frëngjisht, Spanisht, Arabisht, Rusisht dhe Kinezisht në [http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fGC%2f8&Lang=en](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fGC%2f8&Lang=en)

“Në përjashtimin të çdo justifikimi të dhunës dhe poshtërimit si forma të ndëshkimit të fëmijëve, Komisioni në asnjë mënyrë nuk përjashton konceptin pozitiv të disiplinës. Zhvillimi i shëndetshëm i fëmijëve varet nga prindërit dhe të rriturit e tjerë për udhëzime dhe drejtime të nevojshme, në përputhje me kapacitetet evoluese të fëmijëve, për të ndihmuar rritjen e tyre drejt jetës së përgjegjshme në shoqëri.”

Sigurisht, mund të ketë raste kur mësimdhënësit duhet të përdorin forcën trupore, për shembull në trajtimin e situatave të rrezikshme. Në këto raste, përgjigja duhet të jetë proporcionale, bazuar në parimin e forcës minimale të nevojshme dhe synon mbrojtjen dhe jo ndëshkimin. Siç shpjegon Komisioni (paragrafi 15):

“Komisioni pranon se ka rrethana të jashtëzakonshme në të cilat mësimdhënësit dhe të tjerët, p.sh. ata që punojnë me fëmijët në institucione dhe me fëmijët që janë në konflikt me ligjin, mund të ballafaqohen me sjellje të rrezikshme që justifikojnë përdorimin e kufizimit të arsyeshëm për ta kontrolluar atë. Mirëpo, edhe këtu ekziston një dallim i qartë në mes të përdorimit të forcës të motivuar nga nevoja për të mbrojtur një fëmijë apo të tjerët dhe përdorimit të forcës për të ndëshkuar. Parimi i përdorimit minimal të domosdoshëm të forcës për periudhën më të shkurtër të domosdoshme duhet të zbatohet gjithmonë. Kërkohet gjithashtu udhëzim i detajuar dhe trajnim, si për të zvogëluar në minimum nevojën për të përdorur kufizimin, ashtu edhe për të siguruar që çdo metodë e përdorur është e sigurtë dhe proporcionale me situatën, dhe se nuk përfshin shkaktimin e qëllimshëm të dhimbjes si një formë kontrolli.”

(iii) **Respekti kundrejt frikës.** Respekti nuk duhet të ngatërrohet me frikën. Sjellja “e mirë” për shkak të frikës nga ndëshkimi do të thotë që një fëmijë shmang dënimin, duke mos treguar respekt. Ndëshkimi trupor mund të duket efektiv kur rezulton në pajtim të menjëhershëm, por efektet e tij negative afatshkurtra dhe afatgjata - duke përfshirë zhvillimin kognitiv dhe rezultatet arsimore më të dobëta, dhe duke kontribuar në braktisjen e shkollës<sup>6</sup> – në fakt e pengojnë të mësuarit dhe dëmtojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënies.

Fëmijët mësojnë të respektojnë me të vërtetë njerëzit dhe gjërat atëherë kur e vlerësojnë vlerën e tyre të brendshme. Kur mësimdhënësit tregojnë respekt për dinjitetin dhe integritetin njerëzor të fëmijëve, fëmijët mësojnë të respektojnë veten dhe të tjerët. Kur mësimdhënësit i dispiplinojnë fëmijët në mënyra pozitive dhe jo të dhunshme, ata mësojnë se konflikti mund të zgjidhet pa e dëmtuar këtë respekt. Format pozitive të disiplinës janë të dizajnuara për të siguruar që fëmijët të mësojnë të mendojnë për të tjerët dhe për pasojat e veprimeve të tyre. Ekzistojnë shumë materiale në dispozicion për të mbështetur menaxhimin jo të dhunshëm në klasë, të cilat mund të përshtaten dhe të përkthehen për përdorim në secilin vend.<sup>7</sup>

6. Iniciativa globale (2016), “Corporal punishment of children: review of research on its impact and associations”, në dispozicion në <http://endcorporalpunishment.org/research/impact-corporal-punishment.html>

7. Shumë prej këtyre janë listuar në uebfaqen e Iniciativës globale [www.endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org); isa shembuj janë dhënë në Pjesën III: Uebfaqe dhe burime të dobishme





# **E kuptoj që goditja e një fëmije deri në lëndim ose vdekje është e papranueshme, mirëpo nëse ndiqen si duhet rregulloret për administrimin e ndëshkimit trupor, ky i fundit paraqet një element të rëndësishëm dhe efektiv të politikës disiplinare të një shkolle?**

Rrahja e një fëmije mund ta lëndojë fizikisht atë më shumë se një goditje e lehtë, por të dyja janë në një linjë të dhunës dhe të dyja shkelin të drejtën e fëmijës për respektimin e dinjitetit njerëzor dhe integritetit trupor. Shoqëritë nuk përpiqen të përcaktojnë nivelet e pranueshme të forcës atëherë kur sfidojnë dhunën ndaj të moshuarve, për shembull, ku toleranca zero shpreh qartë mesazhin se çfarëdo lloj dhune është e papranueshme. Pra, pse duhet të jetë e përshtatshme që të përpiqemi të përcaktojmë nivelet e pranueshme të dhunës kur bëhet fjalë për fëmijët?

Gjithashtu, është e pasaktë të sugjerohet që të rriturit kanë kontroll të saktë mbi shkallën e dhunës që e përdorin. Të rriturit shpesh nuk e kuptojnë ndryshimin në madhësi dhe forcë midis tyre dhe një fëmije, dhe ndikimin që ky ndryshim mund ta ketë në dhimbjen trupore të synuar dhe atë vërtetë të ndjerë nga fëmija. Hulumtimet e mëdha në të cilat prindërit janë pyetur për forcën e përdorur kur “kanë goditur lehtë” fëmijën e tyre, është parë se dy nga pesë

prej tyre kishin përdorur një shkallë të ndryshme të forcës se sa që e kishin menduar.<sup>8</sup> Dhe hulumtimet nga Instituti i Psikiatrisë dhe Kolegji Universitar i Londrës zbuluan se ndryshimet në aktivitetin e trurit kur përdoret forca në situata të “shpagimit” natyrisht çon në përshkallëzim të shkallës së forcës së përdorur dhe në pasaktësi në gjykimin se sa forcë po përdoret.<sup>9</sup>


Ligjberësit dhe qeveritë tradicionalisht janë përpjekur që të ndajnë ‘abuzimin e fëmijëve’ dhe ‘ndëshkimin trupor’, por pjesa më e madhe e abuzimit është ndëshkim trupor - të rriturit që i sulmojnë fëmijët për t’i dënuar ata dhe për të fituar kontrollin. Ka pasur raste të shumta ku ndëshkimi trupor në shkollë është përshkallëzuar dhe ka rezultuar me vdekje ose dëmtime serioze dhe të përhershme të fëmijës.

8. Kirwaun, S. & Bassett, C. (2008), “Presentation to NSPCC: Physical punishment”, Byroja britaneze e hulumtimit të tregut/Shoqëria kombëtare për parandalimin e mizorisë tek fëmijët

9. Shergill, S. S. et al (2003), “Two eyes for an eye: The neuroscience of force escalation”, Shkencë, vëllimi 301, 11 korrik 2003, p. 187

Në lidhje me arritjet e fëmijëve në shkollë, ndëshkimi trupor ka treguar qartë se ka efekte të dëmshme në zhvillimin kognitiv të fëmijëve dhe në rezultatet arsimore dhe ai kontribuon në braktisjen e shkollës (shih Pjesën 1: Parimet bazë). Për më tepër, ka pasur një ndryshim në të kuptuarit e procesit mësimor. Edukatorët tani e dinë se larg nga marrja pasive e dijes, nën kontrollin e plotë të mësimdhënësit, fëmijët mësojnë më mirë kur ata janë pjesëmarrës aktivë në mësim-nxënien e tyre, me mësimdhënësin që i udhëheq dhe e lehtëson mësimin përmes ofrimit të stimulimit dhe angazhimit të mundësive arsimore. Menaxhimi i mirë i klasës varet jo vetëm nga reagimet jo të dhunshme ndaj sjelljes së nxënësve që konsiderohen të papranueshme, por edhe nga mësimdhënësit e kualifikuar dhe të trajnuar mirë, duke i angazhuar nxënësit në një kurrikulë të përshtatshme dhe stimuluese brenda një ambienti që përkrah njësor të rriturit dhe fëmijët.

Fëmijët nuk shihen më si pronë e prindërve të tyre, por si njerëz me të drejtën e tyre, dhe ky ndryshim në perspektivë zbatohet në mënyrë të barabartë për mësimdhënësit dhe të tjerët që punojnë si prindër kujdestarë apo *“në vend të një prindi.”* Si qenie njerëzore, fëmijët gëzojnë të drejtat e njeriut - dhe këto nuk ndalen tek dyert e shkollës. Fëmijët kanë të njëjtën drejtë si të rriturit për t'u mbrojtur nga goditja dhe lëndimi. Nëse ndëshkimi i shkaktuar është në përputhje me rregulloret e shkollës, goditja e një fëmije shkel të drejtën e fëmijës për respektimin e integritetit të tij trupor. Dhe çdo ndëshkim trupor që është i ligjshëm pasqyron një shkelje të së drejtës së fëmijëve, sipas ligjit, për mbrojtje të barabartë nga sulmet.



# **Disa shkolla fetare thonë që besimi i tyre kërkon nga ato që të përdorin ndëshkim trupor. A është diskriminim ndalimi i tyre që ta bëjnë këtë?**

Disa shkolla fetare mund t'i referohen teksteve të tyre fetare që kërkojnë përdorimin e ndëshkimit trupor. Goditja e fëmijëve nuk është në përputhje me idealet, vlerat dhe besimet e feve kryesore në botë, të cilat tregojnë dhembshuri, barazi, drejtësi dhe jo-dhunë. Adhuresit e feve botërore e modelojnë jetën e tyre sipas shembullit dhe mësimave të themeluesve të tyre. Studiuesit dhe teologët theksojnë se nuk ka prova të regjistruara për asnjë nga themeluesit e feve kryesore që të kenë goditur një fëmijë.

Pikëpamja fetare që dënon ndëshkimin trupor të fëmijëve shpesh rrjedh nga një kulturë e autoritarizmit, fuqisë dhe kontrollit mbi fëmijët. Ajo e konsideron bindjen e verbër si një virtyt dhe dënimin trupor si një përgjigje të pranueshme për fëmijët që konsiderohen “të pabindur”.

Udhëheqësit fetarë janë pjesë e lëvizjes globale për eliminimin e ndëshkimit trupor të fëmijëve. Më shumë se 800 liderë fetarë në Asamblenë Botërore të Feve për

Paqe në Kioto, Japoni (2006) miratuan një deklaratë - *Një angazhim shumë-fetar për kundërshtimin e dhunës ndaj fëmijëve (Deklarata e Kiotos)*<sup>10</sup> – e cila kërkon nga qeveritë që të miratojnë ligje që ndalojnë të gjitha llojet e dhunës ndaj fëmijëve, duke përfshirë edhe ndëshkimin trupor.<sup>11</sup>

Komisioni për të Drejtat e Fëmijës, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 8, pohon se liria fetare “mund të kufizohet ligjërisht në mënyrë që të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve”.<sup>12</sup> Ky Komision thekson:<sup>13</sup>

“Disa justifikime të bazuara në besim për ndëshkimin trupor, duke sugjeruar që interpretimet e caktuara të teksteve fetare jo vetëm që e justifikojnë përdorimin e saj, por edhe paraqesin një detyrë për përdorimin e saj. Liria e besimit fetar mbrohet për të gjithë në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (neni 18), por praktika e një feje apo besimi duhet të jetë në përputhje me respektimin e dinjitetit njerëzor dhe integritetit trupor të të tjerëve....”

10. Teksti i plotë i deklaratës është në dispozicion në <http://churchesfornon-violence.org/wp/wp-content/uploads/2012/02/Violence-Against-Children-3.pdf>

11. Për më shumë informata, shihni [www.churchesfornon-violence.org](http://www.churchesfornon-violence.org)

12. Komenti i përgjithshëm nr. 8, para. 29

13. Komenti i përgjithshëm nr. 8, para. 29

# **Shumë mësime dhe personel të shkollave janë në stres nga menaxhimi i klasave të mbingarkuara dhe kjo për shkak të mungesës së burimeve. A nuk do ta shtonte edhe më shumë stresin e tyre ndalimi i ndëshkimit trupor?**

Ky argument është pranuar i heshtur i një të vërtete të qartë: ndëshkimi trupor është shpesh një mënyrë e shfryrjes për ndjenjat e ndrydhura të të rriturve, më shumë se sa një përpjekje për të edukuar fëmijët. Shumë shkolla kanë nevojë urgjente për më shumë burime dhe mbështetje, por çfarëdo që problemet e vërteta të të rriturve të jenë, çlirimi i tyre tek fëmijët nuk mund të justifikohet. Mbrojtja e fëmijëve nuk duhet të presë përmirësimet në botën e të rriturve, më shumë se mbrojtja e grave nga dhuna që nuk duhet të presë përmirësimin e kushteve/gjendjes së burrave.

Sidoqoftë, goditja e fëmijëve nuk është e efektshme në lehtësimin e stresit. Të rriturit që godasin nga zemërimi shpesh ndihen fajtorë; Ata që godasin gjakftohtë zbulojnë se kanë fëmijë të zemëruar dhe të inatosur për t'u përballuar. Jeta në shkolla ku është braktisur ndëshkimi trupor në favor të disiplinës pozitive është shumë më pak stresuese për të gjithë.



Është e vërtetë që shumë mësime punojnë në kushte shumë të vështira. Ata mund të jenë jo të trajnuar mirë, të paguar pak dhe të nënvlerësuar, klasat e tyre mund të jenë të mëdha dhe shkollat mund të kenë burime të pakta për qeverisje. Ata mund të jenë kundërshtues ndaj ndryshimeve në praktikën e mësimit që nuk shoqërohen me burime ose përkrahje adekuate. Për të mbështetur mësuesit që të largohen nga ndëshkimet trupore, qeveritë duhet të investojnë në trajnim dhe mbështetje të duhur të mësuesve, në burime të duhura për shkollat dhe në qeverisje më të mirë arsimore, si dhe hartim të ligjit për ndalim.

Kur paraqiten siç duhet, për shembull krahas trajnimit rreth dëshmive mbi efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor dhe efektet pozitive të disiplinës jo të dhunshme, mësimi i mësuesve për aftësi të reja të menaxhimit pozitiv të klasës dhe eliminim të përdorimit të ndëshkimit trupor mund të transformojë profesionin e mësimit dhe mjedisin shkollor në të mirë si të mësuesve ashtu edhe nxënësve.

# Ne tashmë kemi politikë ministrore/në shkollë kundër ndëshkimit trupor. Pse është e nevojshme që të ndryshohet edhe ligji?

Në disa shtete, politikat, udhëzimet ministrore dhe/ose kodet e disiplinës theksojnë se ndëshkimi trupor nuk duhet të përdoret, por kjo nuk ndalohet në legjisllacion, i cili ose heshtë për këtë çështje ose e dëmton politikën duke autorizuar shprehimisht ndëshkimin trupor.<sup>14</sup>

Miratimi i një politike kundër ndëshkimit trupor pranon se ndëshkimi është i gabuar dhe i dëmshëm për procesin e mësim-nxënies - por mos mbështetja e kësaj politike me legjisllacion është e paqartë, i vë mësimdhënësit në një pozicion të paqartë ligjor dhe nuk siguron si duhet të drejtën e fëmijëve për një arsimim të sigurt dhe pa dhunë.

Është e nevojshme të miratohet ndalesa eksplicite e ndëshkimit trupor, në mënyrë që të jetë plotësisht e qartë se ndëshkimi trupor nuk është më i pranueshëm.

14. Për listën e shteteve që kanë politika kundër ndëshkimit trupor, mirëpo jo edhe ndalim me ligj, shihni Iniciativën Globale për t'i dhënë fund ndëshkimit trupor të fëmijëve (2015), "Towards non-violent schools: prohibiting all corporal punishment". Raport global 2015, faqe 5



# Pjesa 3: Uebfaqe dhe burime të dobishme

**Komisioni afrikan i ekspertëve për të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve (2011), "Statement on Violence against Children",**

<http://endcorporalpunishment.org/assets/pdfs/reference-documents/ACERWC-statement-on-VAC-2011-EN.pdf>

**Menaxhimi i klasës Online –**

<http://classroommanagementonline.com/index.html>

**Komisioni për të drejtat e fëmijës (2001),**

**Komenti i përgjithshëm nr.1 për "Qëllimet e arsimit",**

[http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fGC%2f2001%2f1&Lang=en](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fGC%2f2001%2f1&Lang=en)

**Komisioni për të drejtat e fëmijës (2006), Komenti i përgjithshëm nr. 8 për "Të drejtën për mbrojtje ndaj ndëshkimit trupor dhe formave të tjera mizore dhe degraduese të ndëshkimit (nenet 19, 28(2) dhe 37, midis tjerash)",**

[http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fGC%2f8&Lang=en](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fGC%2f8&Lang=en)

**Komisioni për të drejtat e fëmijës (2011), Komenti i përgjithshëm nr.13 për "Të drejtën e fëmijëve për të qenë të lirë nga çdo formë e dhunës",**

[http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fGC%2f13&Lang=en](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRC%2fC%2fGC%2f13&Lang=en)

**Këshilli i Evropës, fushata rajonale "Ngritni duart kundër goditjes!" –**

[www.coe.int/en/web/children/corporal-punishment](http://www.coe.int/en/web/children/corporal-punishment)

**Këshilli i Evropës (2007), "Abolishing corporal punishment of children:**

**Questions and answers", Strasburg: Këshilli i Botimit në Evropë,**

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168046d05e>

**Edukimi Botëror –**

[www.educationworld.com](http://www.educationworld.com)

**Fushata Globale për Arsim**

[www.campaignforeducation.org](http://www.campaignforeducation.org)

**Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve –**

[www.endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org)

**Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve**

**(2009), "Prohibiting corporal punishment of children: A guide to legal reform and other measures",**

[www.endcorporalpunishment.org/resources/technical-publications-on-law-reform/legal-reform-handbook-2009.html](http://www.endcorporalpunishment.org/resources/technical-publications-on-law-reform/legal-reform-handbook-2009.html)

**Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve (2012), "Resources for eliminating corporal punishment in schools",**

<http://endcorporalpunishment.org/resources/thematic-reports/resources-for-eliminating-corporal-punishment-in-schools.html>

**Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve (2015), "Towards non-violent schools: prohibiting all corporal punishment". Raport Global 2015,**

<http://endcorporalpunishment.org/resources/thematic-reports/schools-report-2015.html>

**Partneriteti global për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve**

[www.end-violence.org](http://www.end-violence.org)

**"Gordon Training International"**

[www.gordontraining.com](http://www.gordontraining.com)

**Komisioni ndër-amerikan për të drejtat e njeriut (2009), "Report on corporal punishment and human rights of children and adolescents",**

<http://endcorporalpunishment.org/assets/pdfs/reference-documents/IACHR-report-on-corporal-punishment-2009.pdf>

**Mësoni pa Frikë**

<https://plan-uk.org/act-for-girls/about-because-i-am-a-girl/learn-without-fear>

**Prindërit dhe Mësimdhënësit Kundër Dhunës në Arsim**

[www.nospank.net/books.htm](http://www.nospank.net/books.htm)

**Nisma e Azisë Jugore për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve, fushatë rajonale "Equal protection for children"**

[www.saievac.org/cp](http://www.saievac.org/cp)

**Agjenda e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030**

<http://www.un.org/sustainabledevelopment/>

**UNICEF (2001), "Child protection: discipline and violence",**

[www.unicef.org/teachers/protection/violence.htm](http://www.unicef.org/teachers/protection/violence.htm)

**Zyra për hulumtime e UNICEF – "Innocenti" (2015), "Corporal Punishment in Schools: Longitudinal Evidence from Ethiopia, India Peru and Viet Nam",**

[www.younglives.org.uk/sites/www.younglives.org.uk/files/Corporal%20Punishment%20in%20Schools.pdf](http://www.younglives.org.uk/sites/www.younglives.org.uk/files/Corporal%20Punishment%20in%20Schools.pdf)

# Koha ka ardhur që të përfundojë i gjithë ndëshkimi trupor ndaj fëmijëve. Fëmijët kanë të drejtë për respekt dhe për mbrojtje të barabartë nga të gjitha format e dhunës tash!

## **Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve**

Nisma Globale për t'i Dhënë Fund Ndëshkimit Trupor të Fëmijëve promovon ndalimin e përgjithshëm dhe eliminimin e ndëshkimit trupor, dhe ofron mbështetje teknike dhe këshilla për të gjitha aspektet e reformës ligjore.

[www.endcorporalpunishment.org](http://www.endcorporalpunishment.org)

[info@endcorporalpunishment.org](mailto:info@endcorporalpunishment.org)

[www.twitter.com/Glencorpun](https://www.twitter.com/Glencorpun)

[www.facebook.com/Glencorporalpunishment](https://www.facebook.com/Glencorporalpunishment)

## **Save the Children Suedi**

Save the Children Suedi avokon për ndalimin e ndëshkimit trupor në të gjitha mjediset. Në vitin 1979, Save the Children Suedi ka kontribuar që Suedia të bëhet vendi i parë në botë që të ndalojë shprehimisht ndëshkimin trupor. Kjo organizatë po punon në theksimin e kësaj çështjeje për arritjen e një ndalimi ligjor dhe eliminimin e ndëshkimit trupor dhe për ta vënë këtë çështje në agjendën politike në mbarë botën.

[info@rb.se](mailto:info@rb.se)

[www.raddabarnen.se](http://www.raddabarnen.se)

[resourcecentre.savethechildren.net](http://resourcecentre.savethechildren.net)





Global Initiative to  
End All Corporal Punishment  
of Children



**Save the Children**



---

**SWEDEN**

---